


RAPORTI VJETOR 2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Analizë e aktivitetit vjetor të Institucionit

03/25/2018



Indeksi:

I. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME	2
1- HYRJE	2
2- KORNIZA LIGJORE E ZBATUESHME	4
3- REFORMA LIGJORE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KPP	7
4- BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL	8
5- MARRËDHËNIET ME ORGANIZMA NDËRKOMBËTARË	10
6- HARTIMI I AKTEVE RREGULLATORE	11
II. ORGANIZIMI I BRENDSHËM	13
1- STRUKTURA DHE ORGANIKA	13
1.1. Struktura	13
1.2. Organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës	14
1.3. Ristrukturimi	15
1.4. Politika e menaxhimit të burimeve njerëzore	16
2- PERFORMANCA FINANCIARE	17
2.1. Realizimi i buxhetit të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2017	17
2.2. Parashtrime mbi mjaftueshmërinë e fondeve	18
2.3. Të ardhurat jashtë Buxhetore	20
3- FAQJA E INTERNETIT DHE DIXHITALIZIMI	24
III. VEPRIMTARIA E KPP NË SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË ANKESAVE	27
1- TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI PROCESIN E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE	27
2- TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI ANKESAT	29
3- KATEGORIZIMI I ANKIMEVE SIPAS NUMRIT TOTAL DHE VLERËS SË TYRE PËR SECILIN AUTORITET KONTRAKTOR, LLOJIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT, SI DHE FAZA E PROCESIT PËR TË CILIN ËSHTË PARAQITUR ANKIMI	32
4- KATEGORIZIMI I ANKIMEVE SIPAS NUMRIT TOTAL TË ANKIMEVE TË REFUZUARA DHE VLERËS SË TYRE PËR SECILIN AUTORITET KONTRAKTOR, LLOJIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT, SI DHE FAZËN E PROCESIT PËR TË CILIN ËSHTË PARAQITUR ANKIMI	40
5- KATEGORIZIMI I ANKIMEVE SIPAS NUMRIT TOTAL TË ANKIMEVE TË PRANUARA DHE VLERËS SË TYRE PËR SECILIN AUTORITET KONTRAKTOR, LLOJIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT, SI DHE FAZËN E PROCESIT PËR TË CILIN ËSHTË PARAQITUR ANKIMI	42
6- PROCESET GJYQËSORE LIDHUR ME VENDIMET E KPP-SË PËR PERIUdhËN JANAR 2017- DHJETOR 2017	43
7- KUSHTET PËR PRANIMIN E ANKIMEVE DHE ARSYET MË TË ZAKONSHME PËR PARAQITJEN E ANKIMEVE	44
8- PROBLEMATIKAT E IDENTIFIKUARA NË FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË ANKIMIT PËR PROKURIMIN PUBLIK	46
9- E DREJTA PËR INFORMIM	47
OBJEKTIVA PËR TË ARDHMEN	49

I. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

1- HYRJE

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) paraqet për herë të parë para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Raportin Vjetor të aktivitetit të tij, për vitin 2017.

Komisioni i Prokurimit Publik është themeluar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Institucioni filloi funksionimin me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” dhe për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 659, datë 03.10.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik me mjete elektronike”.

Referuar përcaktimeve të bëra në këtë ligj, Komisioni i Prokurimit Publik shfaqet në cilësinë e organit më të lartë administrativ në shqyrtimin e ankesave në fushën e prokurimeve publike, procedurave të koncensioneve/partneritetit publik privat, ankandeve publike dhe procedurave konkurruese të dhënies së lejeve minerare.

Gjatë vitit 2017, falë një sërë ndryshimesh ligjore, është arritur ndryshimi thelbësor përsa i përket statusit të këtij institucioni, dhe konkretisht me ligjin nr. 47/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar”, ka ndryshuar linja e varësisë së tij funksionale dhe natyra e institucionit.

Tashmë, nga një institucion në varësi të Kryeministrit (pushtetit ekzekutiv), KPP ka kaluar në varësi të Kuvendit përsa i përket linjës së raportimit të tij, dhe nga organ i administratës publike që i përket pushtetit ekzekutiv, do të jetë një institucion i pavarur zgjedhja e anëtarëve të të cilit bëhet nga Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave.

Pikërisht pavarësia e KPP ishte një arritje e objektivave të vendosura në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 edhe si pasojë e propozimeve të shumta të organizmave të huaj monitorues si Komisioni European, SIGMA dhe Banka Botërore.

Në këtë mënyrë, është realizuar korniza ligjore e nevojshme që siguron përmbushjen e pothuajse të gjitha kërkesave themelore për organet dhe procedurat e shqyrtimit të prokurimit publik të përcaktuara nga Marrëveshja e Prokurimit Qeveritar (GPA) e vitit 1994 e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), e rishikuar në shkurt të vitit 2014, nga Ligji Model i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Tregtare Ndërkombëtare (UNCITRAL), dhe nga legjislacioni përkatës i BE-së.

Sipas këtyre kërkesave bazë, organi përgjegjës për sigurimin e rishikimit administrativ në procedurat e prokurimit, duhet që:

- të konsiderohet si organ që ka karakter *quasi-gjyqësor*;
- të jetë i krijuar me ligj;
- të ketë karakter të përhershëm dhe jo *ad-hoc*;
- juridiksioni i tij të jetë i detyrueshëm administrativisht;
- procedura e tij është në mes të palëve (*inter partes*);
- të jetë i pavarur dhe të zbatojë parimin e ligjshmërisë.

Raporti Vjetor i KPP, është një ndër format dhe mënyrat kryesore nëpërmjet të cilit pasqyrohet veprimtaria e këtij institucioni, realizohet llogaridhënia para Kuvendit dhe niveli i nevojshëm i përgjegjshmërisë dhe njëkohësisht është një ndër argumentet dhe faktet, se ky institucion e pasqyron dhe e bën publike veprimtarinë e tij, në kuadër të transparencës, mbrojtjes së të drejtave të operatorëve ekonomikë dhe zbatimit të legjislacionit përkatës nga ana e autoriteteve kontraktore.

Parimet themelore të funksionit të KPP përveç parimeve të përgjithshme të prokurimit publik - mosdiskriminimi, transparenca dhe barazia në trajtim e ofertuesve – përfshijnë edhe parimet e mëposhtme: paanshmëria në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmëria në vendimmarrje, ligjshmëria, shpejtësia dhe efënca, aksesi, karakteri publik, si edhe parimi i kontradiktoritetit.

Komisioni i Prokurimit Publik, me veprimtarinë e tij, luan gjithashtu një rol të rëndësishëm për rritjen e besimit të palëve nëpërmjet vendimeve të paanshme që merr, si dhe jep garancinë e mbrojtjes ligjore për të gjithë pjesëmarrësit e sistemit të prokurimit publik,

koncesioneve/partneritetit publik privat, ankandeve publike dhe procedurave konkurruese të dhënies së lejeve minerare.

Kjo praktikë, e bazuar edhe në praktikat më të mira për procedurat e rishikimit administrativ të procedurave të prokurimit, mendojmë se, ka ndikim pozitiv në zhvillimin sa më të drejtë dhe efikas të procedurave të prokurimit nga autoritetet kontraktuese, duke synuar parandalimin e çdo veprimi të kundërligjshëm që cënon interesat e operatorëve ekonomikë, dëmton transparencën, barazinë dhe konkurrencën dhe mbi të gjitha ruajtjen e fondeve publike, të shpenzimit të tyre me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë.

2- KORNIZA LIGJORE E ZBATUESHME

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është një organ publik juridik i krijuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Institucioni filloi funksionimin me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” dhe për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 659, datë 03.10.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik me mjete elektronike”, i ndryshuar.

Në ushtrimin e funksioneve të tij, ky Komision e mbështet veprimtarinë e tij në legjislacionin në fushën e prokurimeve publike, koncensioneve/PPP, ankandeve publike dhe lejeve minerare.

Konkretisht aktet ligjore dhe nënligjore të zbatueshme gjatë realizimit të funksioneve të KPP janë si vijon:

- Legjislacioni në fushën e prokurimit publik:

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;
- Vendimi Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Vendim nr. 184, datë 17.03.2010 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik

- dhe për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 659, datë 03.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik me mjete elektronike”, ndryshuar me VKM-në Nr. 122, datë 22.02.2012;
- Vendim nr. 261, datë 17.03.2010 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”.
- Legjislacioni në fushën e koncesioneve:
- Ligji nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”; i ndryshuar
 - Vendimi nr. 575, datë 10.7.2013 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/ Partneritet Publik Privat”; i ndryshuar;
 - Vendim nr. 575, datë 10.7.2013 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/partneritet publik privat”;
 - Vendim nr. 469, datë 16.06.2010 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”;
 - Vendim nr. 401, datë 13.05.2015 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë prokurimi të koncesionit/partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”;
 - Vendimi nr. 268, datë 18.04.2012 të Këshillit të Ministrave “Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të dhënies së koncesionit”;
 - Vendim nr. 634, datë 01.10.2014 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat, të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, i ndryshuar;

• Legjislacioni në fushën e ankandeve:

- Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 1719, datë 17.12.2008 i Këshillit të Ministrave nr. “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”;
- Vendimi nr. 33, datë 19.01.2011 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “për procedurën e shqyrtimit, nga Komisioni i Prokurimit Publik, të ankesave ndaj procedurave të ankandit apo vendimeve për përjashtim nga këto procedura” e ndryshuar me VKM-në Nr.120, datë 22.2.2012;
- Vendimi nr.56, datë 19.01.2011 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedure ankimi ndaj procedurave të ankandit publik apo vendimeve për përjashtim nga to, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”.

• Legjislacioni në fushën e lejeve minerare:

- Ligji nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendim nr. 942, datë 17.11.2010 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e Lejeve Minerare në Zonat e Hapura”;
- Vendim nr. 320, datë 21.04.2011 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e Lejeve Minerare në Zonat Konkurruese”;
- Vendim nr. 301, datë 20.4.2016 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 320, datë 21.4.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e Lejeve Minerare në Zonat Konkurruese”.

3- REFORMA LIGJORE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KPP-së

Me ndryshimet e fundit të bëra me ligjin nr. 47/2017, datë 13.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, u realizua pavarësia ligjore dhe institucionale e Komisionit të Prokurimit Publik nga pushteti ekzekutiv, duke u përmbushur kështu një nga angazhimet kryesore të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020, gjithashtu edhe një detyrim që rrjedh nga marrëveshjet me partneret ndërkombëtarë, në veçanti me Bashkimin Europian dhe Bankën Botërore.

Konkretisht, referuar ndryshimeve të mësipërme, Komisioni i Prokurimit Publik, nga person juridik publik në varësi të Kryeministrit që financohet nga Buxheti i Shtetit, është përcaktuar tashmë ligjërisht si një person juridik publik i pavarur, që financohet nga Buxheti i Shtetit.

Në të njëjtën linjë, është edhe ndryshimi ligjor në drejtim të mënyrës së zgjedhjes së anëtarëve dhe kryetarit të KPP-së, të cilët emëroheshin nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Kryeministrit, ndërkohë që me ndryshimet e fundit, zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, sipas një procedure konkurruese në zbatim të ligjit nr. 47/2017, datë 13.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Rrjedhimisht, duke qenë tashmë një institucion i pavarur i krijuar me ligj, Komisioni i Prokurimit Publik bart edhe detyrimin që të paraqesë periodikisht raportin vjetor përpara Kuvendit.

Një tjetër ndryshim ligjor është edhe ndryshimi i afateve në lidhje me shqyrtimin *prima facie* të ankesave duke u parashikuar një kohë më e gjatë për verifikimin e kushteve dhe elementeve formale të cilat duhet të përmbushen për marrjen në shqyrtim të ankesave nga ana e KPP-së, si dhe për nxjerrjen e vendimit përfundimtar.

Në lidhje me ankesat në proces, si edhe procedurën e tyre të shqyrtimit, referuar përcaktimeve në dispozitat tranzitore të neneve 76/4 dhe 76/5 të ligjit nr. 47/2017, datë 13.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, gjatë vitit 2017, Komisioni i Prokurimit Publik, për

shqyrtimin e ankesave të paraqitura përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka zbatuar dispozitat në fuqi në momentin e paraqitjes së ankesës.

Për shqyrtimin e ankesave të paraqitura pas datës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore, KPP do të zbatojë rregullat për organizimin dhe funksionimin që janë në fuqi, deri në miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e KPP-së, të cilat sipas nenit 76/5, të ligjit nr.47/2017 do të miratohen nga vetë Komisioni brenda 30 ditëve nga fillimi i punës/emërimi i të gjithë anëtarëve të tij nga Kuvendi.

Në vijim të ndryshimeve ligjore, tashmë struktura dhe organika, si edhe numri i punonjësve dhe buxheti i Komisionit të Prokurimit Publik miratohen nga Kuvendi, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4- BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Gjatë vitit 2017, Komisioni i Prokurimit Publik ka bashkëpunuar dhe raportuar periodikisht pranë Ministrisë së Integritit, dhe në vijim pranë Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, në lidhje me angazhimet e marra përsipër për të përmbushur në mënyrë eficiente direktivat e BE-së për fushën e prokurimeve publike. Në këtë kuadër është dhënë kontribut në përgatitjen e Planit Kombëtar për Integrimin European (PKIE) 2018 - 2020, Kapitulli 5 “Prokurimi Publik”, si një ndër indikatorët kryesorë për mbështetjen buxhetore për Reformën në Administratën Publike.

Gjithashtu, ka patur bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave lidhur me Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në raportimin e monitorimit 6 mujor dhe vjetor të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike (SMFP), si angazhim për përmbushjen e indikatorit nr.5 “Forcimi i Sistemit të Rishikimit Administrativ në Prokurimin Publik”.

Në ushtrimin e detyrave të tij ligjore, KPP ka bashkëpunuar në vijimësi me Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), si menaxhuese e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE), ku në bazë të dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik:

- KPP ka njoftuar rregullisht APP në rastet e marrjes së vendimeve për pezullimin e procedurave të prokurimit, me qëllim që këto vendime të pasqyrohen në sistemin e prokurimit elektronik për të mos lejuar autoritetet kontraktore në vazhdimin e mëtejshëm të procedurës;
- KPP ka njoftuar rregullisht APP në rastet e marrjes së vendimeve përfundimtare si dhe zbatueshmërinë e këtyre vendimeve të KPP nga ana e autoriteteve kontraktore;
- KPP ka njoftuar sistematikisht APP-në në rastet e konstatimit për shkelje eventuale ligjore nga autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, duke i propozuar kësaj të fundit nisjen e hetimit administrativ, sipas tagrave që i përcakton legjislacioni për prokurimin publik. Gjatë vitit 2017, në 6 raste i është kërkuar APP-së fillimi i hetimit administrativ dhe në 2 raste është kërkuar fillimi nga APP i procedurave për përjashtimin e operatorit ekonomik;
- KPP ka nxjerrë rekomandime të përbashkëta me APP-në për çështje të caktuara, si p.sh. “Rekomandimi mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës për shërbimin privat të ruajtjes fizike” të datës 06.02.2017, dhe të datës 20.12.2017.

Komisioni i Prokurimit Publik ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme respektimin e detyrimit ligjor nga autoritetet kontraktore për vënien në dispozicion të informacionit përkatës të nevojshëm për të realizuar në mënyrë të plotë shqyrtimin administrativ. Në rastet e mosrespektimit të këtij detyrimi nga ana e autoriteteve kontraktore, KPP i ka propozuar APP-së marrjen e masave administrative, sipas nenit 73 të ligjit “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Gjatë vitit 2017, Komisioni i Prokurimit Publik ka bashkëpunuar nëpërmjet dhënies së mendimit në lidhje me projektaktet ligjore e nënligjore që prekin procedurat e prokurimit, koncensionet/ppp, ankandet e lejet minerare. Konkretisht, KPP ka përgatitur komentet në lidhje me:

- Ndryshimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”);
- Projektvendimin e Ministrisë së Financave “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 575, datë 10.07.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Konkension/Partneritet Publik Privat”, të ndryshuar;
- Projektvendimin e Ministrisë së Brendshme “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme/Drejtorisë së Blerjeve të Përqëndruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”.

5- MARRËDHËNIET ME ORGANIZMA NDËRKOMBËTARË

Bashkëpunimi me institucionet partnere ndërkombëtare tashmë është pjesë e qëndrueshme e punës së Komisionit të Prokurimit Publik. Gjatë këtij viti janë organizuar disa trajnime dhe aktivitete të shkëmbimit të eksperiencave me synim rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të KPP-së.

Në këto aktivitete, stafi i KPP-së ka pasur mundësinë të njihet dhe të shkëmbejë përvoja për praktikat më të mira në fushën e prokurimit publik, e njëkohësisht të familjarizohet edhe me zhvillimet më të reja në lidhje me mekanizmat e rishikimit administrativ të prokurimit publik në vendet e BE-së, si dhe në rajon, si dhe me mënyrat dhe metodat më të mira të menaxhimit të institucioneve homologe.

Ndër aktivitetet e realizuara në këtë drejtim, vlen të përmendim:

- Pjesëmarrjen e KPP-së në Konferencën Rajonale të organizuar në prill 2017 nga Regional School of Public Administration (ReSPA), në Ljubjanë, Slloveni, me temë “Perspektivat e prokurimit elektronik në Ballkanin Perëndimor”;
- Seminarin e organizuar në maj 2017 nga UNDP, në Stamboll, Turqi, me temë “Qeverisja transparente dixhitale dhe prokurimi publik”;

- Pjesëmarrjen e KPP-së në Seminarin e organizuar në shtator 2017 nga BERZH, në Tbilisi, Gjeorgji, me temë “Promovimi i ciklit dixhital të prokurimit publik dhe qeverisjes së hapur”;
- Seminarin e përbashkët të organizuar në Tetor 2017 nga KPP, UNDP dhe Open Contracting Partnership, në Tiranë, me temë “Open data, open contracting and public procurement”;
- Bashkëpunimin dhe kontributin ofruar ekipeve të Bankës Botërore për realizimin e kapitullit mbi sistemin e shqyrtimit të ankesave të prokurimit publik, përkatësisht në hartimin e Vlerësimit të Financave dhe Shpenzimeve Publike (PEFA) 2017 dhe Raportit të Prokurimeve dhe Kontratave Publike për Shqipërinë (CPCI) 2017;
- Bashkëpunimin sistematik me stafin e Bankës Botërore me synim përthithjen e projekteve të asistencës për KPP, që ka rezultuar me aplikimin për një grant zhvillimi prej 300.000 USD nga SAFE Trust Fund, i financuar nga Banka Botërore dhe Komiteti Europian, me objekt “Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të KPP, zhvillimi i bazës metodologjike (manuale dhe udhëzime) në procesin e shqyrtimit të ankesave dhe edukimi i autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë në lidhje me procedurat e ankimimit pranë KPP”.

6- HARTIMI I AKTEVE RREGULLATORE

Komisioni i Prokurimit Publik aktualisht ushtron funksionet e tij bazuar në VKM nr. 184, datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik dhe për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 659, Datë 03.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik me Mjete Elektronike”, e ndryshuar me VKM-në Nr. 122, datë 22.02.2012.

Nga ana tjetër, referuar nenit 19/7, pika 5 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, rregullat e hollësishme të organizimit dhe të funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik, miratohen nga vetë Komisioni me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

Në nenin 76/3, të ligjit nr. 9643 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *“Mandati i Kryetarit dhe anëtarëve ekzistues të Komisionit të Prokurimit Publik përfundon më 1 janar 2018[...]. Në rast se kryetari dhe/ose anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik nuk emërohen deri në datën 1 janar 2018, sipas parashikimeve të nenit 19/2, të këtij ligji, anëtarët aktualë do të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, deri në përfundimin e procedurës së emërimit”*.

Në datën 26.02.2018, është zgjedhur nga Kuvendi vetëm Kryetari i KPP-së, ndërkohë që anëtarët e tjerë të tij vijojnë të mbeten në detyrë, përse kohë që nuk është bërë përzgjedhja dhe emërimi i anëtarëve të rinj nga Kuvendi.

Gjendur në këtë situatë faktike, në mungesë të rregullave të reja të hollësishme të organizimit dhe të funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik, ndërmjet të cilave përfshihen edhe ato për raportin vjetor, mospërmbylljes së procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe zgjedhjes së fundmi të Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik, KPP, vijon ushtrimin e funksioneve të tij duke u mbështetur në aktet nënligjore që janë aktualisht në fuqi.

Në momentin më të parë të konstituimit të institucionit me të gjithë anëtarët të emëruar nga Kuvendi, rrjedhimisht do të miratohen brenda 30 ditëve edhe rregullat e hollësishme të procedurave dhe të funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe rregullorja e brendshme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të strukturave përkatëse të Komisionit të Prokurimit Publik, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.


II. ORGANIZIMI I BRENDSHËM

1- STRUKTURA DHE ORGANIKA

Në muajt e parë të vitit 2017, në zbatim të nenit 19/6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, KPP ka funksionuar nëpërmjet strukturës dhe organikës të përcaktuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 35 datë 01.03.2016 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Komisionit të Prokurimit Publik” dhe më pas e ndryshuar me anë të Urdhërit të Kryeministrit nr. 60, datë 12.05.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Komisionit të Prokurimit Publik”.

Bazuar në aktet nënligjore të sipërcituara, struktura dhe organika e Komisionit të Prokurimit Publik, aktualisht është si më poshtë vijon:

1.1. Struktura



1.2. Organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës

Kryetar	1	II-a (VKM Nr. 454, datë 11.8.2011 i ndryshuar)
Sekretar	1	Kl. VIII (VKM Nr. 717, datë 23.6.2009 i ndryshuar)
Zevendëskryetar	1	II-B (VKM Nr. 545, datë 11.8.2011 i ndryshuar)
Anëtar	3	II-B (VKM Nr. 545, datë 11.8.2011 i ndryshuar)
Përgjegjës Sektori i Shqyrtimit të Ankesave	1	III-a/1 (VKM Nr. 454, datë 11.8.2011 i ndryshuar)
Inspektor	14	III-b (VKM Nr. 545, datë 11.8.2011, i ndryshuar)
Përgjegjës Sektori i Shërbimeve Mbështetëse	1	III-a/1 (VKM Nr. 545, datë, 11.8.2011, i ndryshuar)
Specialist IT	1	IV-a (VKM Nr. 545, datë, 11.8.2011, i ndryshuar)
Specialist Finance / Buxheti	1	IV-a (VKM Nr. 545, datë, 11.8.2011, i ndryshuar)
Specialist Arkiv / Protokolli	1	IV-b (VKM Nr. 545, datë, 11.8.2011, i ndryshuar)
Specialist/jurist	2	IV-a (VKM Nr. 545, datë, 11.8.2011, i ndryshuar)
Specialist	1	IV-a (VKM Nr. 545, datë, 11.8.2011, i ndryshuar)
Sanitar	1	Kl. I/1 (VKM Nr. 717, datë 23.6.2009 i ndryshuar)
Shofer	1	Kl. IV (VKM Nr. 717, datë 23.6.2009 i ndryshuar)

Gjatë vitit 2017, për plotësimin e vendeve vakante të punës në Komisionin e Prokurimit Publik, përmes procedurave të parashikuara në ligjin nr.152/2013 “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar, janë bërë rekrutime si më poshtë vijon:

- Inspektor, në Sektorin e Shqyrtimit të Ankesave – 3 punonjës;
- Specialist Jurist, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse – 1 punonjës;
- Specialist, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse – 1 punonjës;

Në përfundim të vitit 2017, Komisioni i Prokurimit Publik rezultoi me 6 pozicione pune vakante, përkatësisht 5 pozicione pune Inspektor në Sektorin e Shqyrtimit të Ankesave dhe 1 pozicion pune Përgjegjës Sektori i Shqyrtimit të Ankesave.

1.3. Ristrukturimi

Bazuar në ndryshimet e fundit ligjore, me anë të ligjit 47/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ndryshon varësinë e tij administrative, nga institucion në varësi të Kryeministrit, në institucion me personalitet juridik publik të pavarur.

Sa më sipër, nga data 1 Janar 2018, organika, stuktura dhe numri i punonjësve të Komisionit të Prokurimit Publik do të miratohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Në këtë linjë, procesi i rekrutimit të punonjësve për plotësimin e vendeve vakante të punës, do të vijojë menjëherë pas miratimit të strukturës së re nga Kuvendi i Shqipërisë dhe do të bëhet në përputhje me të.

1.4. Politika e menaxhimit të burimeve njerëzore

KPP ka synuar që edhe gjatë vitit 2017 të zbatojë një politikë të burimeve njerëzore që mishëron vlerat, parimet dhe objektivat e përgjithshme të menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën publike duke pasur si objektiv që, si anëtarët e KPP edhe stafi të jenë të pajisur me aftësitë dhe dijet sa më të përditësuara dhe të dëshmojnë angazhim maksimal ndaj zbatimit të parimeve etike, për të kryer veprimtarinë e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe me efikasitet maksimal.

KPP ka mbajtur në konsideratë përveç zbatimit rigoroz të kërkesave të legjislacionit në fuqi për shërbimin civil, edhe orientimin drejt zhvillimit të vazhdueshëm e të qëndrueshëm profesional nëpërmjet procedurave transparente të rekrutimit, promovimit dhe sigurimit të kompetencës profesionale. Menaxhimi efektiv dhe profesional i burimeve njerëzore është jetik dhe thelbësor për një institucion eficient të shqyrtimit administrativ të prokurimit publik.

Gjatë vitit 2017, struktura e Komisionit të Prokurimit Publik, ka trajtuar një numër të lartë ankesash të paraqitura nga operatorë të ndryshëm ekonomikë, duke marrë pjesë njëkohësisht në projekte të ndryshme në dobi të rritjes së cilësisë dhe kredibilitetit të institucionit, si dhe duke dhënë kontribute në mënyrë direkte ose indirekte në përmirësimin e legjislacionit shqiptar në fushën e prokurimeve publike.

Gjithashtu, pavarësisht nga numri i vogël i stafit në raport me detyrat dhe volumin e punës me të cilën duhet të përballen, duke punuar me frymën e ekipit, si dhe duke organizuar e racionalizuar me efikasitet burimet njerëzore ekzistuese, KPP ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në raportimet periodike për procesin e integritetit dhe përafrimin e legjislacionit me direktivat e BE-së, lidhur me fushën e prokurimeve publike.

Vlerësimi i rezultateve në punë të punonjësve dhe procesi i vlerësimit të performancës së tyre, është kryer çdo 6 muaj, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin në fuqi për statusin e nëpunësit civil, duke mbajtur në konsideratë ngarkesën voluminoze, përditësimin

e njohurive në të gjitha fushat që kryqëzohen në shqyrtimin administrativ të ankesave për prokurimet publike si dhe parimet e konfidencialitetit dhe ruajtjes së të dhënave.

Sidoqoftë, për të orientuar sa më shumë burime njerëzore në procesin e shqyrtimit të ankesave, që është dhe aktiviteti bazë i KPP-së, duke iu përgjigjur kështu dinamikave të reja të ligjit dhe akteve nënligjore të prokurimit publik, do të jetë e nevojshme që me rastin e rishikimit të strukturës dhe organikës së KPP-së dhe miratimit të saj nga Kuvendi, të vlerësohet mundësia e shtimit të pozicioneve përgjegjëse për aktivitetet ndihmëse dhe plotësuese, si dhe ekuivalentimi i pozicioneve të punonjësve të KPP-së me pozicionet e njëjta apo të ngjashme, të përcaktuara sipas VKM nr. 901, datë 19.12.2007 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, nëpunësve të kabineteve dhe punonjësve mbështetës në administratën e disa institucioneve të pavarura”.

2- PERFORMANCA FINANCIARE

2.1. Realizimi i buxhetit të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2017

Mbështetur në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, si edhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, procesi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2017, si dhe situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit të institucionit Komisioni i Prokurimit Publik, për periudhën Janar - Dhjetor 2017, paraqitet si vijon:

Shpenzimet e përgjithshme, bazuar në buxhetin e vitit 2017 (përfshirë të gjithë zërat e buxhetit 600, 601, 602, 231), në fund të vitit, kanë arritur në vlerën 28,119.6 mijë lekë, nga 34,400.0 mijë lekë të parashikuara në buxhetin për vitin 2017, duke u realizuar në masën 81.7% të planit vjetor ose me një mosrealizim prej afërsisht 6,280.4 mijë lekë.

Tabela 1 Realizimi i buxhetit 2017

Titulli	Emërtimi	Buxheti 2017 (në mijë lekë)	Realizimi për vitin 2017	
			në mijë lekë	në %
87	Komisioni i Prokurimit Publik	34,400.0	28,119.6	81.7%
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik			

Shpenzimet korrente në fund të vitit, kanë arritur në shumën 28,119.6 mijë lekë ose rreth 84.2% e buxhetit për vitin 2017, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 5,280.4 mijë lekë.

- Zëri “Paga”, që është artikulli i parë, 600, rezulton se është shfrytëzuar në vlerën 21,490.6 mijë lekë, nga 21,800.0 mijë lekë të parashikuara në buxhetin e vitit 2017. Pra, kemi një përdorim të fondit të pagës në masën afërsisht 98.6%.
- Artikulli 601 “Kontribute për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore”, rezulton me një realizim në vlerën 3,345.7 mijë lekë, nga 4,600.0 mijë lekë të parashikuara në buxhetin e vitit 2017, pra realizuar afërsisht 72.7%.
- Artikulli 602, përkatësisht “Shpenzime për mallra e shërbime”, rezulton me një realizim vjetor në vlerën 3,283.3 mijë lekë nga 7,000.0 lekë të parashikuara në buxhetin e vitit 2017 për institucionin tonë, ose afërsisht me 46.9 % të planit vjetor.

Shpenzimet kapitale deri në fund të vitit, janë realizuar në masën 0.0 mijë ose rreth 0% e planit vjetor, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 1,000 mijë lekë.

2.2. Parashtrime mbi mjaftueshmërinë e fondeve

Bazuar në treguesit e Tabelës 2 më poshtë, mund të konstatojmë, që situata ekonomike gjatë vitit 2017, për KPP ka qenë e qëndrueshme dhe optimale.

Në përgjithësi, të gjithë zërat e buxhetit janë realizuar brenda masës së planifikuar në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2017-2019.

Shpenzimet dhe investimet më të rëndësishme dhe të domosdoshme për Komisionin e Prokurimit Publik janë realizuar me efikasitet, duke bërë që edhe puna të vijojë me efektshmëri dhe duke plotësuar të gjitha nevojat e punonjësve për një mjedis të përshtatshëm pune.

Pra, duke bërë një përmbledhje mbi mjaftueshmërinë e përdorimit të fondeve për vitin 2017, nga Komisioni i Prokurimit Publik, për të gjithë zërat e buxhetit, situata paraqitet si mëposhtë vijon:

Tabela 2 Të dhënat analitike të realizimit të buxhetit

Artikulli	Emërtimi	Buxheti 2017 në mijë lekë	Realizimi për vitin 2017	
			në mijë lekë	në %
600	Paga	21,800.0	21,490.6	98.6%
601	Sigurime shoq.& shëndetësore	4,600.0	3,345.7	72.7%
602	Mallra e shërbime të tjera	7,000.0	3,283.3	46.9%
600 - 606	TOTAL Shpenzime korente	33,400.0	28,119.6	84.2%
231	Shpenzime kapitale	1,000.0	0.0	0.0%
231	TOTAL Shpenzime kapitale	1,000.0	0.0	0.0%
	TOTAL BUXHET	34,400.0	28,119.6	81.7%

Gjithashtu, gjatë periudhës 12.09.2017 – 15.11.2017, bazuar në programin e auditimit nr.859/1prot., datë 12.09.2017, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Komisioni i Prokurimit Publik, ishte subjekt i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën 01.01.2015 -31.08.2017.

Në përfundim të auditimit të ushtruar, Kontrolli i Lartë i Shtetit konkludoi me një vlerësim tepër pozitiv lidhur me zbatimin e buxhetit dhe aktivitetin financiar.

Nëpërmjet Raportit Përfundimtar nr.859/6 prot., datë 30.12.2017, KLSH shprehet se veprimtaria ekonomike e financiare, si dhe mbajtja e kontabilitetit në Komisionin e Prokurimit Publik, është kryer drejtë dhe konform dispozitave ligjore në fuqi.

2.3. Të ardhurat jashtë Buxhetore

a) Tregues mbi të ardhurat jashtë-buxhetore

Ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik bëhen kundrejt pagesës, parashikuar në nenin 63 pika 10 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar. Rregullat dhe tarifrat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave si vijon:

- Vendimi Nr. 261 datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, akt nënligjor i cili rregullon procedurat dhe tarifrat për ankesat në procedurat e prokurimit publik;
- Vendim nr.401, datë 13.05.2015 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë prokurimi të koncesionit/partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, akt nënligjor i cili rregullon procedurat dhe tarifrat për ankesat në procedurat e koncesionit/partneritetin publik privat;
- Vendimi nr.56, datë 19.01.2011 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedure ankimi ndaj procedurave të ankandit publik apo vendimeve për përjashtim nga to, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, akt nënligjor i cili rregullon procedurat dhe tarifrat për ankesat në procedurat e ankandit publik; si edhe
- Vendim Nr. 301, datë 20.4.2016 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 320, Datë 21.4.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e Lejeve Minerare në Zonat Konkurruese,” akt nënligjor i cili rregullon procedurat dhe tarifrat për ankesat në procedurat konkurruese të lejeve minerare.


Në rastet kur në fund të procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës, ankimimi i një operatori ekonomik është pranuar, vlera e tarifës financiare të paguar i kthehet ankimuesit, ndërsa në rastet kur në fund të procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës, ankimimi i një operatori ekonomik nuk pranohet, vlera e tarifës financiare (e ardhura e arkëtuar nga tarifa e ankimimit) derdhet 100 % në Buxhetin e Shtetit, bazuar në përcaktimet e bëra në aktet e mësipërme nënligjore.

Në total, sipas Tabelës 3, e cila përmban vetëm shumatat e tarifave të paguara për vendime të marra nga KPP gjatë vitit 2017, shumata prej 52,146,068 lekë i është kthyer operatorëve ekonomikë ankimues, të cilëve u është pranuar ankesa në bazë të vendimeve të marra deri në datën 31 Dhjetor 2017, ndërsa shumata prej 59,607,977 lekë, që rezultojnë nga vendimet jo në favor të ankimuesve, ka kaluar në buxhet të shtetit. Dy shumatat e mësipërme u shtohet edhe një tjetër shumë prej 17,734,926 lekë, të cilat janë arkëtuar nga KPP gjatë vitit 2017, vendimet e të cilave janë marrë gjatë vitit 2018. Rrjedhimisht tarifatat financiare të paguara nga këta operatorë ekonomikë do të rimbursohen gjatë vitit 2018.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik ka realizuar 129,488,971 lekë gjatë vitit 2017 si të ardhura jashtë-buxhetore.

Tabela 3 Të Ardhura Jashtë-Buxhetore

	Totali i të ardhurave viti 2017	
	Në lekë	Në %
Të kthyer ankimuesve për ankesa të pranuar	52,146,068	40.3%
Derdhur në buxhet për ankesa të papranuar	59,607,977	46.0%
Kthehen ankimuesve në 2018 për ankesa të pranuar gjatë 2017	17,734,926	13.7%
TOTAL të ardhura të arketuara gjatë 2017	129,488,971	100%

Tabela 4 Të dhëna statistikore në % të totalit të ardhurave jashtëbuxhetore

Në analizë të të dhënave statistikore, rezulton se 120,087,844 lekë nga totali i të ardhurave jashtë buxhetore, ose 92.74 % e të ardhurave janë nga tarifat e mbledhura për ankesat për procedurat e prokurimit publik, vijuar me 5.36 % e të ardhurave nga tarifat e mbledhura për ankesat për procedurat e koncesionit/ppp, 1.71 % e të ardhurave nga tarifat e mbledhura për ankesat për procedurat e lejeve minerare dhe 0.19 % e të ardhurave nga tarifat e mbledhura për ankesat për procedurat e ankandeve publike.

Tabela 5 Përmbledhëse sipas objekteve të ankesave

	Çështje me pagesë		Shuma e pagesës	
	Numri	%	Shuma lekë	%
Procedurë prokurimi publik	1,084	98.54%	120,087,844	92.74%
Procedurë koncesioni	4	0.36%	6,946,100	5.36%
Procedurë ankandi	7	0.64%	249,029	0.19%
Procedurë leje minerare	5	0.46%	2,205,998	1.71%
TOTAL	1,100¹	100%	129,488,971	100%

¹ Numri i ankesave gjithsej gjatë 2017 është 1099, ndërkohë që numri i faturave financiare është 1100, pasi ky numër përfshin edhe një faturë për paraqitjen e një ankesë, e cila është prerë nga financa dhe është regjistruar në sistemin bankar, si edhe paguar nga operatori ekonomik në të njëjtën datë - ditën e fundit të vitit 2017, ndërkohë që si ankesë është depozituar në fillimin e vitit 2018.

Në analizimin e të dhënave statistikore mbi shqyrtimin e ankesave gjatë vitit 2017, referuar 6 intervaleve të fondeve limite të procedurave të prokurimit/ankandeve/lejeve minerare dhe koncesioneve/PPP, shqyrtuar gjatë vitit 2017, konstatohet se 48.45 % e ankesave të administruara pranë KPP-së gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit nga 1,000,001 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH deri në 5,000,000 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH.


Aktualisht, KPP nuk mban asnjë pjesë të të ardhurave të arkëtuara nga ankimuesit e pasukseshëm, të cilat nëse qoftë edhe pjesërisht do të mbeteshin si fonde të KPP-së, do të bënin të mundur realizimin e një sërë objektivash për rritjen e cilësisë dhe kapaciteteve profesionale të KPP-së.

Në mënyrë të përmbledhur, të dhënat statistikore, duke u mbështetur në fondin limit, garancinë e ofertës, ose vlerën e investimit të përcaktuar në çdo rast konkret nga autoritetet kontraktore, paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 6 Numri i ankesave të paraqitura sipas intervalit të fondit limit

Intervalet e fondit limit pa TVSH		Procedurat e prokurimit me pagesë pranë KPP	
Nga	Deri	Nr. Çështjeve	Në %
800,001	1,000,000	44	4 %
1,000,001	5,000,000	533	48.45%
5,000,001	10,000,000	195	17.73%
10,000,001	50,000,000	210	19.09%
50,000,001	100,000,000	69	6.27%
Mbi 100,000,000		49	4.46%
TOTAL		1,100	100%

Tabela 7 Të dhëna statistikore në % të ankesave të paraqitura sipas intervaleve të fondit limit



3- FAQJA E INTERNETIT DHE DIXHITALIZIMI

Komisioni i Prokurimit Publik, që prej vitit 2010, është i aksesueshëm nëpërmjet faqes së tij zyrtare të internetit (www.kpp.gov.al). Në këtë faqe interneti, çdo person i interesuar mund të aksesojë informacion të nevojshëm lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi mbi prokurimin publik, ankandet publike, koncensionet/ppp, lejet minerare, si dhe procedurat e ankimit lidhur me to. Gjithashtu, subjektet e interesuar mund të njihen në kohë reale me ankesat e paraqitura pranë KPP-së, si dhe me vendimet lidhur me to, në format *pdf*, draft-formularët e ankesave, rekomandime etj.

Faqja zyrtare e internetit e Komisionit të Prokurimit Publik, pasqyron në mënyrë të detajuar të gjitha informacionet, të cilat janë të detyrueshme të publikohen pa kërkesë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si struktura organizative e institucionit, raporte vjetore, programi i transparencës, të dhënat e koordinitorit për të drejtën e informimit etj.

Ndërkohë, Komisioni i Prokurimit Publik, po punon në krijimin e arkivës elektronike në bashkëpunim me UNDP dhe Open Contracting Partnership, për sistemin e *Open Data*, risi në Shqipëri dhe në rajon për përdorimin e sistemit transparent të të dhënave.

Ky është projekti më i ri dhe ambicioz gjatë 7 viteve të funksionimit të KPP-së, mbi dixhitalizimin e arkivës së institucionit si dhe transparencës për vendimmarrjen e qëndrueshme të KPP ndër vite. Kjo nismë do të realizojë:

- krijimin e një sistemi të brendshëm të administrimit të ankesave, si edhe njëkohësisht publikimin e të dhënave në kohë reale mbi çdo ankesë të depozituar pranë KPP-së, duke respektuar rregullat mbi konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe ato me karakter sensitiv;
- mundësimin e dorëzimit të ankesave online nga operatorët ekonomikë (fillimisht nëpërmjet një projekti pilot), duke përfshirë fazën e dërgimit të kërkesës së operatorëve ekonomikë për faturën e pagesës së tarifës dhe dorëzimin e ankesës online duke krijuar shumë me tepër lehtësira për operatorët ekonomikë (kjo kërkon ndërhyrje në ligjin për Prokurimin Publik, pjesë e reformës të të gjithë sistemit).

Në kuadër të parimit të transparencës për publikun, mediat, shoqërinë civile dhe çdo palë të interesuar, duke përfshirë edhe palën ankimuese, KPP do të japë mundësinë e aksesit të informacionit bazik të mjaftueshëm në lidhje me veprimtarinë e tij për shqyrtimin e ankesave. Kjo do të përfshijë zhvillimin e një sistemi database të brendshëm mbi çdo ankesë dhe vendimmarrje nga ana e KPP-së, duke bërë të mundur njëherazi dhe dixhitalizimin e arkivës së institucionit dhe gjurmimin elektronik të çdo ankese në çdo faze të saj.

Gjithashtu, me anë të bashkëpunimit të filluar gjatë vitit 2017 për ndërtimin e këtij sistemi, do të mundësohet zhvillimi i faqes së re web, me një arkitekturë moderne dhe të pasuruar, në të cilën do të pasqyrohen njëherazi vendimet në kohë reale dhe krijimi i një sistemi *smart* në kërkimin e vendimeve sipas filtrave të ndryshme duke u bazuar në praktikën dhe standartet e Open Contracting Partnership.

Nëpërmjet këtij sistemi të ri, do t'i jepet akses i duhur çdo sipërmarrësi vendas dhe të huaj të dorëzojë online një ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me çdo procedurë prokurimi ku ai ka marrë pjesë dhe është i interesuar, procedurë konkurrese për leje minerare, ankand, duke mos patur më asnjë kosto monetare dhe kohore në lidhje me procesin e dorëzimit të ankesave.

Sistemi i ri do të krijojë njëherazi lehtësi edhe për autoritetet kontraktore, si një palë tjetër e procesit tonë vendimmarrës. Autoritetet kontraktore do të kenë mundësinë e komunikimit të drejtëpërdrejtë të dorëzimit të dokumentacionit në kuadër të procedurave të shqyrtimit administrativ me Komisionin e Prokurimit Publik (edhe kjo kërkon ndërhyrje në ligjin për Prokurimin Publik, pjesë e reformës të të gjithë sistemit).

Një risi e këtij sistemi do të jetë edhe qasja e hapur me çdo subjekt të interesuar mbi vendimmarrjen e KPP-së, shoqëri civile, media, si edhe çdo individ. Me anë të sistemit të ri ofrohet mundësia e publikimit në kohë reale të një informacioni të detajuar mbi fazën në të cilën ndodhet çdo procedurë prokurimi. Pra do të mundësohet informacion i detajuar mbi procedurat e prokurimit të ankimuar, nga secili operator ekonomik, për secilin autoritet kontraktor, faza në të cilën ndodhet secila procedurë si edhe vendimi përfundimtar i KPP-së.

Për çdo procedurë të ankimuar do të merret informacioni i plotë dhe në kohë reale mbi numrin e ditëve të shqyrtimit të rastit konkret, nivelin e kompleksitetit të çështjes, datën e dorëzimit të informacionit nga ana e autoritetit kontraktor, dhe në rast se është dashur bashkëpunim dhe informacion nga ente të tjera publike në lidhje me themelin e çështjes. Gjithashtu, çdo subjekt i interesuar mund të informohet në kohë reale mbi rastet kur për të njëjtën çështje prokurimi janë paraqitur më shumë se një ankesë nga operatorët ekonomikë.

Me anë të këtij sistemi, në kuadër të transparencës dhe qënies i hapur me publikun, KPP do të informojë në kohë reale mbi veprimtarinë e tij të përditshme, mbi numrin total të ankesave për çdo muaj, të dhëna statistikore mbi vendimmarrjen e KPP-së, numrin e vendimeve të apeluara në gjykatë, sa prej këtyre janë pranuar apo nuk janë pranuar nga gjykata, numrin e ankesave të dorëzuara brenda dhe jashtë afatit ligjor, numrin dhe përqindjen e ankesave të dorëzuara sipas marzheve të ndryshme të fondeve limite, pa pasur

nevojë të pritët që këto të dhëna të merren në përfundim të vitit kalendarik financiar me publikimin e raportit vjetor të institucionit.

Pra sistemi i ri, synon të mundësojë funksionimin më efikas të veprimtarisë së institucionit në lidhje me procedurat e ankimimit, në drejtim të rritjes së transparencës për palët e interesuara në këtë proces.

III. VEPRIMTARIA E KPP-së NË SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË ANKESAVE

1- TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI PROCESIN E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Komisioni i Prokurimit Publik funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr.8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe eneteve publike”, ligjin nr.9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe me aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore, të zbatueshme rast pas rasti.

Në veprimtarinë e tij, Komisioni respekton parimet e:

- ligjshmërisë;
- barazisë dhe mosdiskriminimit;
- pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje;
- shpejtësisë dhe efikasiteti;
- qëndrueshmërisë në vendimmarrje,
- aksesin dhe karakterin publik;
- kontradiktoritetin

Anëtarët dhe punonjësit e Komisionit, si dhe ekspertët e pavarur kur përfshihen në proces, në ushtrimin e detyrave të tyre në kuadër të një procedure vendimmarrjeje për shqyrtimin

e një ankese, ruajnë të dhënat personale dhe të dhënat që lidhen me sekrete shtetërore ose tregtare.

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit nuk mund të jenë relatorë dhe nuk marrin pjesë në vendimmarrje mbi një ankesë, kur gjenden në një nga rastet e konfliktit të interesit të parashikuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Rregullat mbi përjashtimin e anëtarëve të Komisionit zbatohen edhe për përjashtimin e inspektorëve, ekspertëve dhe specialistëve të pavarur.

Në zbatim të nenit 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, kur nga shqyrtimi në themel i ankesës para lidhjes së kontratës, KPP gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e ligjit “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka të drejtë të disponojë duke vendosur:

- a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;
- b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me ligjin “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;
- ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.

Pas lidhjes së kontratës, kur Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e ligjit “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka të drejtë:

- a) të nxjerrë një interpretim në lidhje me rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;
- b) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së ligjit.

2- TË DHËNA TË PËRGJTHSHME MBI ANKESAT

Referuar ligjit “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik përgatit raportin vjetor, i cili duhet të përmbajë (i) numrin total të ankimeve dhe vlerën e tyre për secilin autoritet kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankim; (ii) numrin total të ankimeve të refuzuara dhe vlerën e tyre, për secilin autoritet kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi; (iii) numrin total të ankimeve të pranuar dhe vlerën e tyre për secilin autoritet kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi; (iv) numrin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik të ankimuar në gjykatën administrative; (v) kushtet për pranimin e ankimeve dhe arsyet më të zakonshme për paraqitjen e ankimeve; (vi) informacion mbi problematikat e identifikuar në funksionimin e sistemit të ankimit për prokurimin publik.

Gjatë periudhës 1 Janar 2017 – 31 Dhjetor 2017, janë regjistruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik 1099 ankesa në total, prej të cilave 1083 ankesa janë paraqitur për procedurat e prokurimit publik, 4 ankesa për procedurat konkurruese koncesione/ppp, 7 ankesa për procedurat e ankandit publik dhe 5 ankesa për procedurat konkurruese leje minerare.

Tabela 8 Të dhëna statistikore për numrin total të ankesave

Ankesa në total të depozituara pranë KPP gjatë vitit 2017		
	Numër	Përqindje
Prokurime Publike	1083	98.54 %
Koncension	4	0.36 %
Ankand	7	0.64 %
Leje minerare	5	0.45 %
Ankesa total	1099	100%

Sqarojmë se siç është përmendur më sipër² pranë Komisionit të Prokurimit Publik janë depozituar 1099 ankesa, ku për 1039³ prej tyre KPP ka dalë me vendimmarrje gjatë vitit 2017. Pra, numri 807 i vendimeve (si numër rendor vendimi) përfshin 784 vendime për shqyrtimin në themel dhe 23 janë vendime për çështje procedurale administrative.

Gjithashtu, sqarojmë se përveç 1099 ankesave të regjistruara gjatë vitit 2017, janë mbartur edhe 19 ankesa të depozituara në vitin 2016, për të cilat janë marrë 18 vendime gjatë vitit 2017. Në 1099 ankesa të depozituara gjatë vitit 2017, për 78 ankesa të regjistruara në fund të vitit 2017, 53 vendimet e lidhura me to, janë marrë gjatë vitit 2018.

Gjatë vitit 2017, Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave të depozituara gjatë vitit 2017 dhe ankesave të mbartura nga viti 2016 ka nxjerrë 784 vendime themeli. Nga totali i vendimeve të nxjerra nga Komisioni i Prokurimit Publik për periudhën në raportim, 18 janë vendime për ankesat e mbartura nga 2016 dhe 766 për ankesat e vitit 2017.

Gjatë vitit 2017 është vënë re një ulje e numrit të ankimeve administrative të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik, krahasuar kjo me vitin paraardhës në raportim.

Konkretisht, në vitin 2016 pranë Komisionit të Prokurimit Publik janë dorëzuar 1393 ankesa.

Duke krahasuar numrin e ankesave të depozituara gjatë vitit 2017, vihet re një ulje me rreth 21.1% ndaj atyre të vitit 2016. Numrin më të madh të ankesave të dorëzuara pranë Komisionit të Prokurimit Publik e mban muaji Mars 2017, ku janë administruar gjithsej 219 ankesa, pasuar nga muaji Prill me 172 ankesa dhe muaji Maj me 120 ankesa. Muaji me më pak ankesa është muaji Shtator 2017, në të cilin janë administruar gjithsej 27 ankesa. Në një vështrim krahasimor me vitin paraardhës (viti 2016) sërish muaji Mars, është muaji me më shumë ankesa (214-2016) pasuar nga Prilli (186-2016 ankesa), ndërsa me numrin më të ulët të ankesave për vitin paraardhës (2016) është muaji Janar me 50 ankesa.

² *Kreu 2 Performanca financiare*

³ 1099 (ankesa 2017) + 19 (ankesa të mbartura 2016) – 77 (ankesa të shqyrtuara 2018) = 1039 (ankesa total 2017).

Gjatë vitit 2017 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur mospranimin e 56 ankesave për shkak se janë dorëzuar jashtë afateve pranë KPP-së dhe/ose pranë autoriteteve kontraktore.

Vlen të theksohet, se viti 2017 nuk ka qenë një vit i zakonshëm në raport me numrin total të ankesave të depozituara në KPP, pasi me Vendimin nr. 482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit për vitin 2017”, janë pezulluar të gjitha procedurat e prokurimit nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi deri në daljen e Vendimit nr.580 datë 13.10.2017, të Këshillit të Ministrave “Për shfuqizimin e Vendimin nr. 482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit për vitin 2017”, me të cilin u hoq kjo masë pezulluese.

Me Vendimin nr. 482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave, u pezulluan gjithashtu edhe afatet e ankimimit pranë KPP-së, gjë që me heqjen e këtij pezullimi nëpërmjet VKM nr.580 datë 13.10.2017, solli edhe ngarkesë e fluks jo normal të ankesave për shqyrtim në 2 muajt e fundit të vitit 2017, krahasuar me të njëjtën periudhë të viteve të mëparshme.

Edhe gjatë vitit 2017 është konstatuar se numrin më të madh të ankesave e zënë ankesat në lidhje me procedurat e prokurimit për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe shoqërim të vlerave monetare me 519 ankesa nga 1039 në total ose 50 % duke shënuar një rënie të vogël krahasuar me 60.5 % që ka qenë pesha e këtyre ankesave në vitin 2016.

Nga ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2017, 50.4 % e tyre janë pranuar nga Komisioni i Prokurimit Publik krahasuar me 49.03 % të pranuar gjatë vitit 2016, 43.1 % janë ankesa të refuzuara krahasuar me 50.83 % gjatë vitit 2016 dhe 6.5 % janë ankesat për të cilat është vendosur mosmarrja në shqyrtim ose pushimi i hetimit administrativ, krahasuar me 0.14 % në vitin 2016.

Gjatë vitit 2017 është përmirësuar ndjeshëm treguesi i lidhur me shpejtësinë e shqyrtimit të ankesave nga KPP, me 45.3 % të ankesave shqyrtuar brenda afatit, krahasuar me 28 % për vitin 2016.

Gjatë vendimarrjes në vitin 2017, Komisioni i Prokurimit Publik, ka vijuar me konsolidimin e praktikës në drejtim të trajtimit të aneksave të paraqitura jashtë afatit, duke mbajtur në konsideratë faktin se, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i ka qëndruar strikt rregullimit të parashikuar nga ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

Gjatë vitit 2017 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur mospranimin e 56 ankesave për shkak se janë dorëzuar jashtë afateve pranë KPP dhe/ose pranë autoriteteve kontraktore, të cilat referuar numrit total, përbëjnë rreth 5% të ankesave të dorëzuara pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjatë veprimtarisë së vitit 2017 janë evidentuar gjithashtu 7 raste (ankesa) me mungesa të kushteve formale ose janë paraqitur pa paguar tarifën përkatëse.

3- KATEGORIZIMI I ANKIMEVE SIPAS NUMRIT TOTAL DHE VLERËS SË TYRE PËR SECILIN AUTORITET KONTRAKTOR, LLOJIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT, SI DHE FAZA E PROCESIT PËR TË CILIN ËSHTË PARAQITUR ANKIMI

Gjatë vitit 2017 pranë Komisionin të Prokurimit Publik janë paraqitur ankesa lidhur me vendimmarrjen për procedurat e prokurimit publik, koncensione/ppp, ankande publike dhe leje minerare për 308 autoritete kontraktore.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik ka marrë vendime lidhur me ankesat e paraqitura për procedura të cilat, në total, referuar fondeve limite, arrijnë një vlerë prej **21.350.943.914 lekë**.

Të dhënat e plota të detajuara në mënyrë analitike për cdo autoritet kontraktor, ku përfshihet numri total i ankimeve dhe vlera e tyre për secilin autoritet kontraktor, lloji i procedurës dhe faza e procesit për të cilin është paraqitur ankimi, gjenden në Aneksin nr.1, bashkëlidhur Raportit.

Në mënyrë grafike më poshtë paraqiten njëzet autoritetet kontraktore me numrin më të lartë të ankesave dhe vlerës më të madhe të fondit limit që i korrespondon procedurave të ankimuar në KPP.

Tabela 9 - Autoritetet Kontraktore me numrin më të lartë të ankesave





Tabela 10 - Autoritetet Kontraktore me vlerë më të lartë të fondit limit të procedurave të ankimuar



Nisur nga numri total i ankesave të shqyrtuara pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se 49.95 % (519) prej tyre janë ankesa për procedurat “Për Shërbimin e Ruajtjes së Sigurisë Fizike”, të cilat përbëjnë numrin më të lartë të ankesave të paraqitura për vitin 2017.

Më poshtë po paraqesim një tabelë me njëzet autoritetet kontraktore që kanë numrin më të lartë të ankimeve për këtë lloj procedure.

Tabela 11 - Autoritetet Kontraktore me numrin më të lartë të ankimeve për shërbimin e ruajtjes së sigurisë fizike

Autoritet	Ankesa
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	24
Cirku Kombëtar	18
Prokuroria Tiranë	12
AKZM	11
OSHEE Shkodër	10
Ministria e Shëndetësisë	9
Posta Shqiptare	9
RTSH	8
Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë	8
D.Sh.Peshkut e Akuakulturës	7
Gjykata Administrative SHK.I	7
Gjykata Lezhë	7
KQZ	7
Ministria e Kulturës	7
S.U “Shqfjet Ndroqi”	7
Spitali Univesitar i Traumës	7
SUOGJ K.Gliozheni	7
AZHBR	6
D.R Jugor Gjirokastër	6

Përsa i përket, procedurave të prokurimit të llojit “shërbime” (pa përfshirë SHRSF), nga përlogaritjet rezulton se janë shqyrtuar 161 ankesa ose 15.5 %, të ankesave në total.

Më poshtë po paraqesim një tabelë me njëzetë autoritetet kontraktore që kanë numrin më të lartë të ankimeve për këtë lloj procedure.

Tabela 12 - Autoritetet Kontraktore me numrin më të lartë të ankimeve për shërbime

Autoritet	Ankesa
Posta Shqiptare	9
Albpetrol sh.a.	8
ARRSH	8
Bashkia Mat	6
Bashkia Elbasan	5
KUVENDI	5
Bashkia Lezhë	4
Q.S “Xhafer Komgoli” Elbasan	3
QSUT	3
UKT	3
Spitali Durrës	3
AKUK	3
UK Durrës	3
Bashkia Shkodër	3
Bashkia Tiranë	3
DPA	3
D.P. Arkivave	3
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	3
Ministria e Bujqësisë	3

Përsa i përket, procedurave të prokurimit të llojit “Punë Publike”, nga përlllogaritjet rezulton se janë shqyrtuar 121 ankesa ose 11.6 %, të ankesave në total.

Më poshtë po paraqesim një tabelë me njëzet autoritetet kontraktore që kanë numrin më të lartë të ankimeve për këtë lloj procedure.

Tabela 13 - Autoritetet Kontraktore me numrin më të lartë të ankimeve për punë publike

Autoritet	Ankesa
AKUK	7
Bashkia Tiranë	7
Bashkia Dibër	7
Bashkia Korçë	6
MMSR	5
Bashkia Shkodër	4
Bashkia Kucovë	4
Bashkia Pogradec	4
Bashkia Librazhd	3
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	3
Bashkia Libohovë	3
FSDKSH	3
FSHZH	3
KESH	3
OSHEE Vlorë	3
Bashkia Elbasan	2
Bashkia Shijak	2
OSHEE Korçë	2
Bashkia Finiq	2

Përsa i përket, procedurave të prokurimit të llojit "Mallra", nga përllogaritjet rezulton se janë shqyrtuar 224 ankesa ose 21.55 %, të ankesave në total.

Më poshtë po paraqesim një tabelë me njëzet autoritetet kontraktore që kanë numrin më të lartë të ankimeve për këtë lloj procedure.

Tabela 14 - Autoritetet Kontraktore me numrin më të lartë të ankimeve për mallra

Autoritet	Ankesa
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	16
Ministria e Punëve të Brendshme	14
Albpetrol sh.a	7
Posta Shqiptare	7
Bashkia Dibër	6
D.R Shëndetësore Shkodër	6
Bashkia Shkodër	5
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	5
UK Vlorë	5
KUVENDI	5
QSUT	5
KESH	4
Bashkia Mat	4
UKT	4
Bashkia Durrës	4
D.P. Punëtorëve nr. 1	4
Qendra Edukimit Zhvillimit Fëmijëve	4
Bashkia Tiranë	3
Bashkia Finiq	3

Lidhur me kategorizimin e ankimeve sipas fazës së procesit për të cilin është paraqitur ankimi, rezulton se nga totali i ankesave të shqyrtuara 278 ankesa ose 26.7 % e ankesave në total, janë paraqitur për kundërshtimin e kriterëve të vendosura nga autoritetit kontraktor në dokumentat e procedurëve përkatëse dhe 761 ankesa ose 73.3% e ankesave në total, janë paraqitur lidhur me vendimet e autoriteteve kontraktore në fazën e vlerësimit të ofertave.

Më poshtë po paraqesim dy tabela me njëzet autoritetet kontraktore që kanë numrin më të lartë të ankimeve për secilën fazë.

Tabela 15 - Autoritetet Kontraktore me numrin më të lartë të ankimeve për DST

Autoritet	Ankesa DST
Posta Shqiptare	19
OSHEE Shkodër	7
Bashkia Elbasan	5
Bashkia Mat	4
QSUT	4
UKT	4
DRSH Vlorë	4
UK Pogradec	4
Autoriteti Rajonal Shëndetësor Tiranë	4
DPT	3
MPB	3
Bashkia Dibër	3
Bashkia Tirane	3
MEI	3
RTSH	3
SUOGJ K.Gliozheni	3
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	3
UPT	3
Gjykata Lezhë	3

Tabela 16 - Autoritetet Kontraktore me numrin më të lartë të ankimeve për Vlerësim

Autoritet	Ankesa Vleresim
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	24
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	18
Cirku Kombëtar	18
Albpetrol sh.a	15
Ministria e Punëve të Brendshme	14
Bashkia Shkodër	12
Prokuroria Tiranë	12
Ministria e Shëndetësisë	11
AKUK	11
AKZM	11
Bashkia Dibër	10
Bashkia Tiranë	10
ARRSH	9
MEI	8
KUVENDI	8
Gjykata Administrative SHK I	8
Bashkia Mat	7
Bashkia Librazhd	7
S .U Shefqet Ndroqi	7

4- KATEGORIZIMI I ANKIMEVE SIPAS NUMRIT TOTAL TË ANKIMEVE TË REFUZUARA DHE VLERËS SË TYRE PËR SECILIN AUTORITET KONTRAKTOR

Të dhënat e plota të detajuara në mënyrë analitike për cdo autoritet kontraktor, ku përfshihen edhe ankesat e refuzuara, gjenden në Aneksin nr. 1 bashkëlidhur Raportit.

Në mënyrë grafike më poshtë paraqiten njëzet autoritetet kontraktore me numrin më të lartë të ankesave të refuzuara, pra vendimet e të cilave janë lënë në fuqi nga KPP.

Tabela 17 - Autoritetet Kontraktore me numrin më të lartë të ankesave të refuzuara

Nr.	Autoriteti Kontraktor	Ankesa		Vlera
		Total	Të refuzuara	
1	Posta Shqiptare	25	17	487,463,178
2	DPT	27	13	98,626,882
3	AKZM	11	11	9,492,765
4	Bashkia Tiranë	13	10	3,066,674,382
5	MPB	17	10	1,781,561,564
6	AKUK	11	10	1,103,469,134
7	Bashkia Shkodër	12	9	115,012,668
8	QSUT	10	7	163,174,699
9	KUVENDI	10	6	69,009,858
10	OSHEE Shkodër	10	6	37,358,132
11	D.R..Shëndetësore Shkodër	6	6	10,861,663
12	Ministria e Integritimit	6	6	6,270,000
13	D. R. Jugor Gjirokastër	6	6	4,230,000
14	ARRSH	10	5	698,191,866
15	Bashkia Mat	11	5	252,371,885
16	Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	9	5	100,884,859
17	MEI	11	5	86,532,507
18	Gjykata Administrative Shk. 1	8	5	3,970,630
19	MMSR	6	4	487,875,967

5- KATEGORIZIMI I ANKIMEVE SIPAS NUMRIT TOTAL TË ANKIMEVE TË PRANUARA DHE VLERËS SË TYRE PËR SECILIN AUTORITET KONTRAKTOR

Të dhënat e plota të detajuara në mënyrë analitike për cdo autoritet kontraktor, ku përfshihen edhe ankesat e pranuar, gjenden në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur Raportit.

Më poshtë paraqiten njëzet autoritetet kontraktore me numrin më të lartë të ankesave të pranuar.

Tabela 18 - Autoritetet Kontraktore me numrin më të lartë të ankesave të pranuar

Nr.	Autoriteti Kontraktor	Ankesa	Të	Vlera
		Total	pranuar	
1	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	27	14	98,626,882
2	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	19	13	372,960,185
3	Albpetrol sh.a.	16	11	121,050,924
4	Prokuroria Tiranë	12	10	15,721,794
5	Ministria e Shëndetësisë	13	9	314,525,521
6	Bashkia Dibër	13	9	144,956,500
7	Posta Shqiptare	25	8	487,463,178
8	Bashkia Elbasan	9	8	386,564,328
9	UKT	9	7	119,900,928
10	S.U Shqfqet Ndroqi	9	7	66,016,259
11	Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë	8	7	988,276
12	Ministria e Punëve të Brendshme	17	6	1,781,561,564
13	Bashkia Librazhd	9	6	321,847,887
14	Bashkia Mat	11	6	252,371,885
15	FSDKSH	7	6	55,888,747
16	Cirku Kombëtar	18	6	6,407,874
17	KQZ	7	6	5,969,497
18	Bashkia Korçë	8	5	333,219,886
19	RTSH	9	5	118,163,645
20	D.SH. Spitalor Kukës	7	5	17,143,528

6- PROCESET GJYQËSORE LIDHUR ME VENDIMET E KPP-SË PËR PERIUdhËN JANAR 2017- DHJETOR 2017

Lidhur me vendimarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 58 vendime nga 784 vendime në total të marra nga Komisioni gjatë vitit 2017.

Në përfundim të procesit gjyqësor në shkallë të parë, gjykata ka vendosur lënien në fuqi për 41 vendime të KPP nga totali i 58 vendimeve të ankimuara, ndërsa për 11 vendime të komisionit, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesë padisë. Pra, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka mbajtur të njëjtin qëndrim me KPP-në, për mbi 70 % të vendimeve të ankimuara.

Vlen të përmëndim se, në krahasim me vitin paraardhës 2016, është ulur në mënyrë të ndjeshme numri i vendimeve të KPP të ankimuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pasi në vitin 2016 janë ankimuar në gjykatë 101 vendime. Pra, në vitin 2017 kemi një rënie me 42.5 % të vendimeve të ankimuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë krahasuar me vitin 2016.

Tabela 19 – Proceset gjyqësor Janar – Dhjetor 2017

Proceset gjyqësore Janar-Dhjetor 2017	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	Gjykata Administrative e Apelit	Gjykata Administrative e Lartë
Rrëzimin e kërkesë padisë	41	-	-
Pranimin e kërkesë padisë	11	-	-
Në proces gjyqësor	6	50	2 vendime nuk janë ankimuar nga paditësi/VFP ⁴
TOTAL (VENDIME KPP 2017)	58	Deri në këtë fazë janë 50 vendime	-

⁴ VFP = Vendim i formës së prerë

Vlen të përmendet, se ndërkohë që dëmi i pretenduar nga palët paditëse në kundërshtimin gjyqësor të 58 Vendimeve të KPP ka qenë 91.014.031 Lekë, dëmi i parandalur nga lënia në fuqi nga gjykata e vendimeve të KPP është 81.841.059 Lekë, ndërsa për një vendim ku dëmi i pretenduar është 9.299.277 Lekë, gjykimi është ende në vijim.

7- KUSHTET PËR PRANIMIN E ANKIMEVE DHE ARSYET MË TË ZAKONSHME PËR PARAQITJEN E ANKIMEVE

Në bazë të parashikimeve të ligjit “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore të zbatueshme, Komisioni i Prokurimit Publik vihet në lëvizje vetëm mbi bazë të ankesës.

Të drejtën për të paraqitur ankesë pranë Komisionit e ka çdo person që ka, ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me ligjin dhe që autoriteti kontraktor pas paraqitjes së ankesës prej tij:

- a) nuk ka shqyrtuar ankesën brenda 7 ditëve nga marrja e saj;
- b) ka refuzuar ankesën; ose
- c) ka vendosur mospranimin e ankesës.

Me marrjen e ankesës me shkrim, Komisioni i Prokurimit Publik sigurohet që autoriteti kontraktor e ka pezulluar procedurën e prokurimit.

Pas një shqyrtimi paraprak të ankesës për plotësimin ose jo të kushteve formale siç janë respektimi i afatit, pagesa e tarifës, respektimi i formës së parashikuar nga ligji për paraqitjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vendos nëse do të vijojë me shqyrtimin në themel të saj dhe respektivisht për vijimin ose jo të pezullimit të procedurës, duke vënë në dijeni për këtë ankimuesin dhe autoritetin kontraktor.

Në shqyrtimin në themel të ankesave, në varësi të fazës së procedurës së prokurimit për të cilën ato janë paraqitur, KPP rast pas rasti ka shqyrtuar ankesa të cilat kanë pasur si objekt respektimin e kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore, të lidhura kryesisht me:

- a. Ankesat e paraqitura për dokumentat e tenderit:
- Respektimin e rregullave për përcaktimin e fondit limit sipas fushës që i përket objekti i prokurimit, referuar përcaktimeve në nenet 27 e vijues të ligjit dhe në rregullat përkatëse të prokurimit;
 - Respektimin e rregullave për përzgjedhjen e llojit të procedurës sipas kufijve përkatës monetarë (procedurë e hapur, e kufizuar, kërkesë për propozim, procedura me negociim, konkurs projektimi, shërbime konsulence, marrëveshje kuadër), si dhe afateve specifike për dokumentat e tenderit dhe njoftimet në lidhje me to, sipas përcaktimeve në nenet 27 e vijues të ligjit dhe në rregullat përkatëse të prokurimit;
 - Respektimin nga autoritetet kontraktore të kërkesave të ligjit për hartimin e specifikimeve teknike sipas përcaktimeve në nenin 23 të ligjit dhe në rregullat përkatëse të prokurimit;
 - Respektimin e rregullave për hartimin e kërkesave dhe dokumentave provuese në lidhje me kriteret e kualifikimit, sipas përcaktimeve në nenin 46 të ligjit dhe në rregullat përkatëse të prokurimit.
 - Ruajtjen e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rastet kur autoritetet kontraktore në hartimin e kërkesave të cilësisë, vendosin kërkesa të tepërta, të panevojshme ose pa lidhje me objektin e prokurimit për çertifikime e akreditime kombëtare ose ndërkombëtare.

Për vitin 2017, nga 1039 ankesa në total, 278 prej tyre ose 26,7 % janë ankesa të paraqitura për dokumentat e tenderit. Nga këto, 132 janë ankesa për dokumentat e tenderit të paraqitura në procedura prokurimi për shërbimet e ruajtjes fizike.

Në këto rrethana, unifikimi dhe bërja e detyrueshme e një pakete kriteresh minimale të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për procedura të njëjta ose të ngjashme, do të rezultonte me ulje të ndjeshme të numrit të ankesave me këtë objekt.

- b. Ankesat e paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave:
- Skualifikim i padrejtë dhe i pabazuar në ligj dhe në rregullat e prokurimit i ankimuesit nga ana e autoriteteve kontraktore për mospërbushje të kriterëve kualifikuese dhe/ose specifikimeve teknike;

- Kualifikim i padrejtë dhe i pabazuar në ligj dhe në rregullat e prokurimit i ofertuesve të tjerë të ndryshëm nga ankimuesi duke u anashkaluar kërkesat e vendosura nga vetë autoritetet kontraktore për përmbushje të kriterëve kualifikuese dhe/ose specifikimeve teknike;
- Mosrespektimi i rregullave për njoftimet dhe komunikimin me pjesëmarrësit në një procedurë prokurimi;
- Mosrespektimi i afateve dhe procedurave të kualifikimit dhe përzgjedhjes nga autoritetet kontraktore, duke kërkuar anulimin e procedurës.

Për vitin 2017, nga 1039 ankesa në total, 761 prej tyre ose 73.3 % janë ankesa të paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave.

8- PROBLEMATIKAT E IDENTIFIKUARA NË FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË ANKIMIT PËR PROKURIMIN PUBLIK

Komisioni i Prokurimit Publik, është institucion relativisht i ri dhe për më tepër ka kaluar nëpër disa ndryshime organizative e funksionale deri sa së fundmi u pozicionua si organ i shqyrtimit administrativ të procedurave të prokurimit i pavarur nga pushteti ekzekutiv, ashtu siç kërkojnë standartet bashkëkohore të menaxhimit të financave publike.

Kjo dinamikë zhvillimi e përball KPP-në me sfida të rëndësishme në drejtim të përmirësimit të performancës së vet të lidhur ngushtësisht me objektin e tij të aktivitetit, por njëkohësisht, për shkak të hapësirave që KPP ka në identifikimin e fenomeneve problematike në nivel sistemi, krjon dhe mundësinë që KPP të kontribuojë në përmirësimin në tërësi të sistemit të prokurimit publik.

Në drejtim të funksionimit të sistemit të ankimit për prokurimin publik, KPP ka identifikuar problematikat në vijim:

- Përdorimi në mënyrë shpeshherë abuzive i instrumentave të ankimit administrativ për prokurimet publike nga shoqëritë e ruajtjes dhe sigurisë fizike, gjë që ka shkaktuar një mbingarkesë të theksuar të KPP-së për këto lloj procedurash në krahasim me procedura të tjera;

- Në një numër të konsiderueshëm rastesh është konstatuar se operatorët ekonomikë nuk janë mjaftueshëm të informuar për formën, afatet dhe procedurat e përcaktuara nga ligji për ankimin administrativ për prokurimin publik. Kjo sjell në shumë raste mospranimin e ankesave të paraqitura vetëm për mosplotësim të kriterëve formale;
- Gjithashtu, mungesa e informacionit të operatorëve ekonomikë si për sistemin e ankimit ashtu dhe për kërkesat e përgjithshme të ligjit për procedurat e prokurimit, sjell shpeshherë ankime të formuluar me objekt të pasaktë, ose të paplotë, c'ka e pengon KPP të evidentojë një gamë më të gjerë shkeljesh nga autoritetet kontraktore për shkak të kufizimit ligjor që ka për të mos dalë jashtë objektit të ankesës gjatë shqyrtimit të saj;
- Volumi shumë i madh i ankimeve që paraqiten në KPP, ka evidentuar nevojën që institucioni jo vetëm të shtojë numrin e stafit të angazhuar në procesin e shqyrtimit të ankimeve, por edhe të rrisë burimet njerëzore që mund të angazhohen në projekte për rritjen e kapaciteteve profesionale të KPP, si dhe në edukimin për procedurat dhe instrumentat e ankimit qoftë të zyrtarëve të prokurimit, ashtu edhe të operatorëve ekonomikë;
- Nga shqyrtimi i ankesave dhe procedurave respektive të prokurimit është konstatuar se autoritetet kontraktore që shfaqin me dendur tendencën për të gabuar në zbatimin e ligjit janë (i) autoritetet kontraktore me numër të vogël punonjësish; (ii) autoritetet kontraktore të pushtetit vendor krahasuar me ato pushtetit qendror; (iii) autoritetet kontraktore që kanë pasur lëvizshmëri të lartë të zyrtarëve të prokurimit.

9- E DREJTA PËR INFORMIM

Në kuadër të zbatimit të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Komisionit të Prokurimit Publik i lind detyrimi për të vënë në dispozicion të publikut informacionin e përcaktuar nga ky ligj pa kërkesë paraprake si dhe informacionin e kërkuar me anë të një kërkesë të posaçme nga subjektet e interesuara.

Gjatë vitit 2017, në zbatim të ligjit, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të Urdhërit Nr. 1012, datë 26.05.2017 “Për miratimin e Programit të Transparencës për Komisionin e Prokurimit Publik” ka miratuar:

- Programin e transparencës;
- Standartin për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve;
- Modelin e kërkesës dhe përgjigjes “Për dhënie të informacionit/dokumentacionit” që rekomandohet të përdoret;
- Aktet shkresore që rekomandohen të përdoren për vendimmarrjet:
 - o “Për refuzimin e formës së kërkuar”;
 - o “Për zgjatjen e afatit”;
 - o “Për rishikimin e dokumenteve të klasifikuara dhe shtyrjen e afatit”;
- Emërimin e Koordinatorit për të drejtën e informimit.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017 janë depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik gjithsej 3 kërkesa për informim. Këto kërkesa janë trajtuar nga koordinatori për të drejtën e informimit brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji. Asnjërës prej kërkesave nuk i është refuzuar dhënia e informacionit. Çdo kërkesë për informacion si dhe kthimi i përgjigjes gjenden të publikuara në faqen zyrtare të institucionit në kuadër të respektimit të parimit të transparencës.

Koordinatori për të drejtën e informimit mban një komunikim të vazhdueshëm me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të transparencës.

Lidhur me informacionin e dhënë subjekteve që kanë kërkuar informacion drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, për vitin 2017, nuk ka patur asnjë ankim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky fakt tregon se Komisioni i Prokurimit Publik ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet që i lindin nga zbatimi i Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” duke mos cënuar në asnjë moment të drejtën e publikut për t’u njohur me informacionin që prodhohet apo mbahet nga institucioni.

OBJEKTIVA PËR TË ARDHMEN

Objektivi kryesor dhe konstant i KPP-së është mbrojtja e interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve kontraktore në zbatimin e ligjshmërisë, në lidhje me prokurimin publik.

KPP do të vijojë t'i kushtojë rëndësi të veçantë profesionalizmit, paañsisë në vendimmarje, transparencës, efikasitetit dhe rritjes së besueshmërisë në sitemin e prokurimit publik.

Në mënyrë të vecantë, për vitin 2018, KPP i ka vendosur vetes objektivat e mëposhtme:

- Hartimi i Planit Afatmesëm Strategjik 2018 – 2020, si një mënyrë për të vendosur objektiva dhe indikatorë të identifikuar qartë dhe të matshëm duke krijuar në këtë mënyrë edhe një dokument bazë referimi për Kuvendin si institucioni monitorues i KPP-së;
- Kuadri ligjor për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë është i plotë dhe i qartë. Pavarësisht kësaj, paraqitet i nevojshëm hartimi nga KPP i manualeve dhe materialeve shpjegues, të lehtë në përdorim, për të gjithë subjektet e interesuar dhe njësitë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik;
- Implementimi i sistemit dixhital të administrimit të ankesave, si edhe njëkohësisht publikimi i të dhënave në kohë reale mbi çdo ankesë të depozituar pranë KPP-së, duke respektuar rregullat mbi konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe ato me karakter sensitiv;
- Zhvillimi i faqes së re web, me një arkitekturë moderne dhe të pasuruar, në të cilën do të pasqyrohen njëherazi vendimet në kohë reale dhe krijimi i një sistemi *smart* në kërkimin e vendimeve sipas filtrave të ndryshme duke u bazuar në praktikën dhe standartet e Open Contracting Partnership;
- Rritja dhe forcimi i aftësive dhe kapaciteteve profesionale si të anëtarëve të KPP-së ashtu edhe të stafit mbështetës nëpërmjet aktiviteteve trajnuese dhe shkëmbimit të eksperiencave, të organizuara nga institucionet të ndryshme vendase dhe partner ndërkombëtarë;

- Institucionet e administratës shtetërore janë më të qarta në rolin që ato kanë në zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik dhe detyrimin për të zbatuar vendimet e KPP, të cilat janë administrativisht përfundimtare. Gjithsesi, akoma më shumë punë duhet bërë në konsolidimin e kapaciteteve të rrjetit të zyrtarëve përgjegjës për prokurimin, të cilët duke qënë monitoruesit e zbatueshmërisë së ligjit në institucionet e tyre, do të rrisin dhe besueshmërinë e publikut në vendimarrjen e institucioneve të tyre;
- Përbushja e detyrimeve takuese të KPP-së si organ i rishikimit administrativ të prokurimeve publike, në drejtim të realizimit të angazhimeve të lidhura me procesin e anëtarësimit në BE dhe raportimet periodike përkatëse;
- Realizimi nëpërmjet mbështetjes me asistencë nga Banka Botërore, i fushatave të informimit dhe ndërgjegjësimit të autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë për rolin dhe funksionet e KPP-së, duke bërë në këtë mënyrë më eficient përdorimin e institutit të ankimimit në KPP dhe duke ndikuar kështu edhe në rritjen e besimit të publikut në sistemin e prokurimit.

Viti 2018, do të jetë një sfidë e veçantë për KPP, për shkak edhe të faktit se është viti i parë gjatë të cilit do të vendoset edhe korniza e bashkëpunimit dhe ndërveprimit të KPP me Kuvendin si institucioni monitorues.

Në këtë drejtim, ne mirëpresim kërkesat, sugjerimet dhe vërejtjet eventuale nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për të raportuar mbi ecurinë e punës, por edhe mbështetjen e nevojshme për miratimin e akteve nënligjore dhe rritjen e forcimit e kapaciteteve, në zbatim të kompetencave ligjore, si një institucion i pavarur, kompetent, i paanshëm në mbrojtje të të drejtave ligjore të çdo operatori ekonomik dhe palëve të interesuara për mbarëvajtjen e sstemit të prokurimit publik.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

MARS, 2018

[Shqiptaria.com]

nr	Autoritet	Nr Ankesa	nr vendime	pranuar an	refuzuar an
1	ADISA	1	1	1	0
2	Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit	1	1	0	1
3	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit	1	1	0	0
4	Agjencia e Trajtimit të Pronave	3	1	3	0
5	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve	2	2	0	2
6	Agjencia Kombëtare e Provimeve	1	1	0	1
7	Agjencia e Sigurimit të Depozitave	1	1	1	0
8	Akademia e Shkencave	2	1	0	2
9	AKBN	1	1	1	0
10	AKEP	3	3	3	0
11	AKSHI	1	1	1	0
12	AKT	1	1	0	1
13	AKU	4	3	4	0
14	AKUK	11	9	1	10
15	AKZM	11	8	0	11
16	Albafilm	1	1	0	1
17	Albcontrol	1	1	1	0
18	Albpetrol	16	10	11	4
19	Albpetrol Patos	1	1	0	1
20	Albpetrol QPN Ballsh	2	2	2	0
21	Aluizni	2	2	1	1
22	Aluizni Tirana Veri	2	2	2	
23	Aluizni Vlorë	3	2	3	0
24	AMF	2	2	1	1
25	Arkivi Qëndror Shtetëror I Filmit	3	1	3	0
26	ARRSH	10	10	4	5
27	ASIG	3	3	2	1
28	ASPA	1	1	0	1
29	Autoriteti Portual Durrës	4	4	2	2
30	Autoriteti Rajonal Shëndetësor Tiranë	4	4	4	0
31	AZHBR	6	2	3	3
32	Bashkia aTropoje	2	2	1	1
33	Bashkia Berat	4	4	3	1
34	Bashkia Bulqizë	3	3	3	0
35	Bashkia Devoll	2	2	0	1
36	Bashkia Dibër	13	11	9	4
37	Bashkia Divjakë	3	3	1	2
38	Bashkia Dropull	1	1	1	0
39	Bashkia Durrës	4	3	0	4
40	Bashkia Elbasan	9	8	8	1
41	Bashkia Fier	2	2	1	1
42	Bashkia Finiq	5	4	2	1
43	Bashkia Fushë-Arrëz	1	1	1	0
44	Bashkia Gjirokastrë	2	2	0	2
45	Bashkia Gramsh	1	1	0	1
46	Bashkia Has	1	1	1	0
47	Bashkia Himarë	1	1	0	1
48	Bashkia Kamëz	1	1	1	0
49	Bashkia Kavajë	5	4	3	2

50	Bashkia Kolonjë	3	3	1	1
51	Bashkia Korçë	8	8	5	3
52	Bashkia Kucovë	6	6	4	2
53	Bashkia Kukës	3	3	0	3
54	Bashkia Lezhë	4	3	2	2
55	Bashkia Libohovë	3	3	2	1
56	Bashkia Librazhd	9	5	6	2
57	Bashkia Lushnje	1	1	0	1
58	Bashkia Malësi e Madhe	2	2	2	0
59	Bashkia Maliq	4	4	1	3
60	Bashkia Mallakastër	1	1	0	1
61	Bashkia Mat	11	5	6	5
62	Bashkia Patos	1	1		1
63	Bashkia Peqin	2	1	1	1
64	Bashkia Perrenjas	2	2	1	1
65	Bashkia Pogradec	5	5	4	1
66	Bashkia Puke	1	1		
67	Bashkia Rrogozhine	1	1	1	
68	Bashkia Sarande	2	2	1	
69	Bashkia Selenice	2	2	2	
70	Bashkia Shijak	3	2	1	2
71	Bashkia Shkoder	12	11	3	9
72	Bashkia Tepelene	2	2	2	
73	Bashkia Tirane	13	11	3	10
74	Bashkia Ura Vajgurore	1	1		1
75	Bashkia Vlore	6	6	3	3
76	Bashkia Vore	2	2		2
77	Biblioteka Kombetare	2	1	2	
78	Bordi I Kullimit Lezhe	1	1	1	
79	Bordi Rajonal I KULLIMIT Fier	2	2	2	
80	Bordi Rajonal I KULLIMIT Korce	4	3	2	2
81	Cirku Kombetar	18	3	6	1
82	D.BUJQ.TIRANë	3	1	3	
83	D.CERDHE KOPSHTE	1	1		1
84	D.Dog. Berat	1	1		1
85	D.Dog.Durrës	3	2	1	2
86	D.SH.T.Diplomatik	3	3		3
87	DAR FIER	2	2	1	1
88	DAR KORÇë	1	1		1
89	DAR Kukës	1	1	1	
90	Dog. Korçë	3	3	1	2
91	Dog. Lezhë	3	2		3
92	Dog.Kapshticë	1	1		
93	Dog.Tiranë	1	1		1
94	Dog.Vlorë	1	1	1	
95	DPA	3	2	1	2
96	DPARKIVAVE	3	2	2	1
97	DPB	19	15	13	4
98	DPD	3	3	1	1
99	DPMETROLOGJISë	1	1		1

100	DPPOLICISë	3	3	1	2
101	DPPUNëTORëVE NR. 1	4	4	1	3
102	DPPUNëTORëVE NR. 2	2	2	1	1
103	DPPUNëTORëVE NR. 3	3	2	2	1
104	DPSHKPUNESIMIT	1	1		1
105	DPSHTRR	3	3	2	1
106	DPT	27	14	14	13
107	DPTTV	3	3	3	
108	DRAJ.BUJQ.USHQIM.KONSUM.ELBASAN	2	2	2	
109	DRAJ.OSHEE TIRANë	2	2	2	
110	DRAJ.SHEND.DIBëR	3	2	1	2
111	DRAJ.SHEND.DURRëS	1	1	1	
112	DRAJ.SHEND.FIER	2	2	2	
113	DRAJ.SHEND.SHKODëR	6	1		6
114	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të P	1	1	1	0
115	Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Durrë	1	1	1	0
116	Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Gjirok	1	1	0	1
117	Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Tiranë	1	1	0	1
118	DRJUGOR GJIROKASTëR	6	2		6
119	DRSH Elbasan	1	1	1	0
120	DRSH Vlorë	6	4	4	2
121	DRSSH Diber	1	1	1	
122	DRSSH Korce	5	3	2	
123	DRSSH shkoder	1	1		1
124	DRSSH Tirane	3	2	1	2
125	DRSSHKukes	1	1		1
126	DRSSHTR Elbasan	1	1		1
127	DRSSHTR Gjirokaster	2	2	1	1
128	DRSSHTR Kukes	4	3	3	1
129	DRSSHTR Sarande	1	1		1
130	DRSSHTR Vlore	2	2		2
131	DRVERIOR SHKODëR	1	1		1
132	DSHP Kurbin	1	1		1
133	DSHP Lushnje	2	2	2	
134	DSHP Mat	3	2	2	1
135	DSHPESHKUT AKUAKULTURëS	7	5	5	2
136	DSHPUBLIK GRAMSH	1	1		1
137	DSHPUBLIK LIBRAZHD	2	2	1	1
138	DSHSPIT HAS	2	1	2	
139	DSHSPIT. KAVAJë	4	1	4	
140	DSHSPIT. LIBRAZHD	2	2	2	
141	DSHSPIT. TEPELENë	1	1		1
142	DSHSPIT.BULQIZë	2	2		1
143	DSHSPIT.DIBëR	2	2		2
144	DSHSPIT.GRAMSH	2	2		1
145	DSHSPIT.KORCë	1	1	1	
146	DSHSPIT.KUKëS	7	5	5	2
147	DSHSPIT.KURBIN	2	1	2	
148	DSHSPIT.MALLAKSTëR	3	2		3
149	DSHSPIT.MAT	1	1	1	

150	DSHSPIT.POGRADEC	1	1	1	
151	DSHSPIT.TROPOJë	2	1	1	1
152	DSHSPITA.KOLONJë	1	1	1	
153	DSPIT.Raj.GJIROKASTër	1	1	1	
154	Eco Tirana	5	5	2	3
155	Enti Fara Fidane	3	1	1	2
156	Enti K Banesave	1	1		1
157	FSDKSH	7	4	6	1
158	FSDKSH Fier	2	2		2
159	FSHZH	3	3		3
160	Galeria Kombetare e Arteve	1	1	1	
161	Garda e Republikës	1	1	1	
162	GJ Administr Apelit	3	1		3
163	Gj Administr SH 1	8	2	2	5
164	Gj Apelit Durres	2	1		2
165	Gj Apelit Korce	2	2	1	1
166	Gj Apelit Vlore	2	2	2	
167	GJ Larte	2	2	1	1
168	Gjakata Elbasan	1	1	1	
169	Gjakata Durres	1	1		1
170	Gjakata e Apelit Tirane	2	2	1	1
171	Gjakata Fier	3	3	2	0
172	Gjakata Korce	2	2	2	
173	Gjakata Krimet e Renda	1	1		1
174	Gjakata Kruje	3	3	1	1
175	Gjakata Kukës	1	1	1	
176	Gjakata Lezhe	7	4	4	3
177	Gjakata Mat	4	1	3	1
178	Gjakata Puke	1	1	1	
179	Gjakata Tirane	3	2	2	1
180	HEC Lanabregas	1	1		
181	ildkpi	3	1		3
182	Inspektoriati Teknik	1	1	1	
183	Inspektoriati Qendror	1	1	1	
184	INSTAT	2	2		2
185	ISHP	1	1		1
186	ISHSH	1	1		1
187	ISHTI	1	1	1	
188	ISKPK	1	1		
189	ISSH	1	1	1	
190	ISUV	4	3	3	1
191	KANTJERI NDëRTIM ANIJEVE	3	1		
192	KESH	7	6	3	4
193	KLINIKA STOMATO.TIRANë	4	3	2	2
194	KOMISIONERI DIMDHP	1	1	1	
195	KQARKUT BERAT	1	1	1	
196	KQARKUT DURRës	1	1		1
197	KQARKUT SHKODër	1	1		1
198	KQZ	7	1	6	1
199	KUVENDI	10	8	4	6

200	M Ekonomise	1	1		1
201	M Integrimt	6	2		6
202	M Kultures	7	3	3	4
203	M Mbrojtjes	3	3		2
204	M Mjedisit	3	1	3	
205	M Shendetesise	13	5	9	4
206	M Transportit	1	1		1
207	MAS	4	4	3	1
208	MEI	11	11	3	5
209	Min Bujqesise	3	3	2	
210	Min Drejtesise	2	2	1	1
211	Min Financave	3	2	3	
212	MIN. JASHTME	1	1		1
213	MMSR	6	4	2	4
214	MPB	17	16	6	10
215	Muzeu Historik Kombetar	1	1	1	
216	MZHUT	3	2	1	2
217	ND Pasuri Publike Lushnje	1	1	1	
218	Nd Sherb Publike Vlore	1	1	1	
219	Ndr Ind Nr 1 Tirane	2	1		2
220	Ndr Serb Mbeshtetese	1	1		1
221	OSHEE	5	5	2	2
222	OSHEE Berat	2	2	2	0
223	OSHEE Durrës	1	1	1	0
224	OSHEE Fier	2	2	2	0
225	OSHEE Gjirokastrë	1	1	0	1
226	OSHEE Korçë	3	2	1	2
227	OSHEE Kukes	1	1		1
228	OSHEE Shkoder	10	9	4	6
229	OSHEE Vlore	3	2	1	2
230	OST	2	2	2	
231	Porti Shngjin	1	1	1	
232	Posta Shqiptare	25	20	8	17
233	Prefekti I qarkut Korce	1	1	1	
234	Prokurori Kurbin	2	2	1	1
235	Prokuroria Diber	1	1	1	
236	Prokuroria Fier	1	1	1	
237	Prokuroria KAVAJE	2	1	1	1
238	prokuroria Korce	4	2		4
239	Prokuroria Lezhe	4	3	3	1
240	Prokuroria Lushnje	3	3	2	1
241	Prokuroria Mat	2	1	2	
242	Prokuroria Tirane	12	3	10	2
243	Prokuroria Tropoje	4	3	1	3
244	Q Ed Zhvillimit Femijeve	4	2		4
245	Q Komb Urgjences Mjekesore	1	1	1	
246	Q Sp Xhafer Komgoli Elbasan	6	4	3	3
247	Q ST Albanologjike	1	1	1	
248	Q T Studenteve	2	2	2	
249	QBZ	2	2		2

250	Qendra Azilkerkuesit	3	2	2	1
251	Qendra Kombetare Biomjek	2	1	2	
252	Qendra Kulturore TR	1	1	1	
253	QK TR Gjakut	3	1		3
254	QSUT	10	9	3	7
255	RTSH	9	8	5	3
256	S U Shqfjet Ndroqi	9	5	7	2
257	SH Pare e Inv FAF	3	3	3	
258	Sherbimi Gjeologjik	6	2	2	
259	Shtepia e Foshnjes Tirane	1	1		1
260	Shtepia E te moshuarve Shkoder	2	2		1
261	Shtyp Letra me vlere	2	1		2
262	Spitali Diber	1	1	0	1
263	Spitali Durres	4	4	4	
264	Spitali Fier	3	3	1	2
265	Spitali Lezhe	2	2	1	1
266	Spitali Lushnje	4	3	2	2
267	Spitali Ps Ali Mihali	8	3	7	1
268	Spitali PS Ssadiq Dinci	4	2	4	
269	Spitali Shkoder	1	1		1
270	Spitali Univesitar i Traumes	8	3	1	1
271	Spitali Vlore	2	2	1	1
272	SUOGJ K Gliozheni	9	7	4	1
273	SUOGJ Mbreteresha Geraldine	3	3	3	
274	Teatri Kombetar	2	1		2
275	Tirana Parking	3	3	2	1
276	Trajtim Studenti Korce	2	2		2
277	Tregu I shitjes me shumice	4	1	4	
278	UK Diber	2	1	2	0
279	UK Durres	4	3	1	3
280	UK fier	1	1	1	0
281	UK Gjirokaster	1	1		1
282	UK Kruje	1	1	1	0
283	UK Lushnje	3	2	2	1
284	UK Mat	3	2	0	3
285	UK Pogradec	5	5	4	1
286	UK Sarande	2	1	2	
287	UK Shkoder	1	1	1	
288	UK vlore	7	5	3	4
289	UKT	9	9	7	1
290	UL Bulqize	3	3	3	0
291	Univ Aleksander Moisiu	3	3	1	1
292	Universiteti Bujqesor	3	2	3	
293	Universiteti I Arteve	3	3	1	2
294	Universiteti I Mjekesie	3	2	3	
295	Universiteti I Sporteve	3	1	3	
296	Universiteti I Tiranës	6	3	2	4
297	Universiteti Ism Qemali Vlore	9	7	4	5
298	UniversitetiAleksander Xhuvani	3	3	2	1
299	UPT	8	6	4	4

300	ZQRPP	3	3	1	2
301	ZVRPP Elbasan	2	2	1	1
302	ZVRPP KOrce	1	1		1
303	ZVRPP Kukes	2	2	1	
304	ZVRPP Lezhe	2	2		1
305	ZVRPP Lushnje	4	1	2	
306	ZVRPP Shkoder	2	2	1	1
307	ZVRPP Vlore	1	1	1	
308	Zyra e Prok Pergjithshem	1	1	0	1
	Shuma	1039	784	524	448

Ishqiptaria.com

mos marre	DST	Vleresim	Rivleresim	vlera	roje	Sherbim jo	pune
0	0	1	1	5,555,093	0	0	1
0	0	1	0	2,080,000	0	0	0
1	0	1	0	17,761,313	1	0	0
0	3	0	0	5,408,622	3	0	0
0	0	2	0	13,813,455	1	0	0
0	0	1	0	2,538,940	1	0	0
0	1	0	0	10,173,085	0	0	0
0	0	2	0	5,000,000	0	2	0
0	1	0	0	2,026,000	1	0	0
0	3	0	0	168,116,666	0	2	1
0	1	0	0	7,975,000	0	1	0
0	0	1	0	7,000,000	0	1	0
0	3	1	1	12,190,418	3	0	0
0	0	11	2	1,103,469,134	0	3	7
0	0	11	0	9,492,765	11	0	0
0	1	0	0	1,048,400	1	0	0
0	1	0	0	12,330,663	0	0	0
1	1	15	11	121,050,924	1	8	0
0	0	1	0	35,628,887	0	0	0
0	0	2	2	53,464,400	0	0	1
0	0	2	1	5,000,000	2	0	0
	2			4,981,558	2		
0	1	2	2	4,126,559	3	0	0
0	1	1	0	28,542,207	0	1	0
0	0	3	3	1,620,480	3	0	0
1	1	9	3	698,191,866	0	8	1
0	2	1	0	76,168,037	2	0	1
0	1	0	0	2,659,200	1	0	0
0	0	4	2	43,893,127	0	2	0
0	4	0	0	23,276,224	1	0	0
0	1	5	1	4,573,048	6	0	0
		2	1	88,429,237			2
0	0	4	3	30,020,318	0	0	1
0	2	1	1	14,932,180	1	0	0
1	0	2	0	26,461,768	0	0	1
0	3	10	6	144,956,500	0	0	7
0	0	3	1	135,685,925	0	0	1
0	1	0	0	18,487,660	0	0	1
0	0	4	0	90,771,000	0	0	0
0	5	4	3	386,564,328	0	5	2
0	0	2	1	129,145,217	0	0	1
2	2	3	0	123,130,645	0	0	2
0	0	1	1	4,815,833	0	0	0
0	0	2	0	28,713,596	0	0	2
0	1	0	0	63,562,371	0	0	1
0	0	1	1	3,870,000	0	0	0
0	0	1	0	139,137,617	0	0	1
0	0	1	1	86,818,451	0	0	1
0	0	5	3	36,443,623	4	0	1

1	0	3	1	87,519,945	0	0	2
0	1	7	5	333,219,886	0	2	6
0	3	3	1	424,448,974	0	2	4
0	0	3	0	85,039,832	0	0	1
0	1	3	1	99,097,081	0	4	0
0	1	2	1	88,411,113	0	0	3
1	2	7	6	321,847,887	0	1	3
0	0	1	0	53,150,081	0	0	1
0	2	0	0	24,558,084	0	2	0
0	0	4	1	201,292,662	0	0	2
0	0	1	0	1,326,999	0	1	0
	4	7	4	252,371,885		6	1
		1		1,905,000		1	
		2	1	1,284,375			
	1	1		82,090,946			2
		5	4	176,160,779			4
1		1		34,594,481			1
	1			1,513,500			
1	1	1		153,147,528			2
		2	2	41,538,952			1
		3	1	79,095,018		1	2
		12	3	115,012,668		3	4
	2			93,592,166			2
	3	10	1	3,066,674,382		3	6
	1			2,317,967			
		6	3	232,009,332		2	1
	1	1		4,500,000		1	
		2		3,635,200	2		
	1			7,521,004	1		
		2	2	7,373,740	1		
	1	3	1	29,233,950	3		
11		18		6,407,874	18		
		3	1	3,116,162	3		
	1			1,041,605			
		1		1,382,232	1		
	1	2			3		
		3		16,060,580		1	
	1	1	1	5,294,907		1	
		1		3,953,000		1	
	1			3,500,000			
	1	2		4,285,345	3		
	3			1,558,748	3		
1		1		2,919,850			
	1			7,235,437	1		
	1			2,299,463	1		
		3	1	15,748,000		3	
	3			5,828,334		3	
2	1	18	12	372,960,185		3	
1		3	1	106,947,728	1	1	1
		1		2,215,455	1		

	3			41,540,760		1	
	1	3		232,500,000			
		2	1	36,814,073			
		3	2	41,303,469			
		1		2,356,100	1		
		3	2	10,842,453		1	1
	3	24	8	98,626,882	24		
	3			11,863,383	1	1	
		2	2	7,712,000		2	
		2	1	139,127,333	1		
	2	1		3,578,532	3		
		1	1	4,884,100	1		
	2			4,046,741	2		
		6		10,861,663			
0	1	0	0	1,614,452	1	0	0
0	0	1	1	1,563,720	0	1	0
0	0	1	0	2,243,064	0	1	0
0	0	1	0	17,787,754	0	1	0
		6		4,230,000	6		
0	1	0	0	1,908,495	1	0	0
0	4	2	1	12,132,813	6	0	0
	1			1,610,125	1		
3	1	4		3,528,968	5		
		1		680,981	1		
	1	2		4,288,666	3		
		1		882,500	1		
		1		474,433	1		
		2	1	982,080	2		
	3	1		6,580,000	4		
		1		491,040	1		
		2		4,038,800	2		
		1		1,839,730	1		
		1		1,320,592	1		
	2			3,219,100	2		
		3		1,250,000	3		
		7	3	7,438,596	7		
		1		1,080,000	1		
	1	1		2,567,518	2		
		2		2,585,000	2		
		4	1	2,470,500	4		
	1	1	1	4,697,620	1	1	
		1		1,335,209	1		
1	1	1		3,750,288	2		
	2		1	9,480,400	2		
1		2		3,797,780	1		
		1	1	1,124,327		1	
	1	6	2	17,143,528	4	1	
		2	1	2,272,917	2		
		3		5,923,723	3		
	1			3,409,490	1		